



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**  
**nr.442, datë 22.11.2016**

**“Për**  
**disa rekomandime mbi projekt/ligjin “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 8691,**  
**datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, të**  
**ndryshuar”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

▪ Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
▪ Servete	GRUDA	Zv/Kryetar
▪ Koço	BROKA	Anëtar
▪ Iva ZAJMI		Anëtar
▪ Eduard	YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.11.2016, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i projekt/ligjit “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, të ndryshuar”.

**Baza ligjore:** Neni 24, gërma d) e f); 69 dhe 70, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të projekt-ligjit “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, të ndryshuar”,

**VËREN SE:**

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, nga Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, ka ardhur për mendim projekt-ligji “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, të ndryshuar”.
2. Autoriteti i Konkurrencës është shprehur me Vendimin nr. 438, datë 05.10.2016 “Mbi disa rekomandime dhe mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit” ku ka rekomanduar:
  - a) Marrjen e masave për hapjen e tregut të grumbullimit të duhanit të prodhuar në vend për të nxitur zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në këtë treg;
  - b) Asistencën e specialistëve të Ministrisë së Bujqësisë gjatë procesit të kategorizimit të duhanit sipas cilësisë dhe vendosjes së çmimeve përkatëse të përcaktuara në kontratat midis palëve gjatë grumbullimit në stacionet e caktuara nga ndërmarrja.
  - c) Monitorimin e realizimit të pagesave nga ana e ndërmarrjes MIKA KORCA SH.A brenda afateve të parashikuara në kontratën e lidhur nga kjo ndërmarrje me fermerët.

3. Bazuar në problematikat e evidentuara në funksionimin e këtij tregu lidhur me ekzistencën e një situatë monopsoniste (një blerës i vetëm), gjë e cila mund të sjellë pasoja negative për konkurrencën në këtë treg duhen adresuar për zgjidhje marrëveshjet grumbullues-përpunues me prodhuesit e duhanit, marrëdhënie të cilat, me të drejtë, janë në qendër të ndryshimeve të propozuara në këtë p/ligj.
4. Në parim projekt/ligji “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, të ndryshuar”, nuk bie në kundërshtim me parimet dhe rregullat e konkurrencës.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, gërma d) e f), nenin 69 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

### **VENDOSI:**

- I. T’i rekomandojë Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin dhe Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, që:

Në projekt/ligjin “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, të ndryshuar”, të shtohet një dispozitë (ose në nenin 9 të projekt/ligjit, i cili bën ndryshime në nenin 21 të ligjit aktual, të shtohet një pikë) ku të përcaktohet bashkëpunimi i Agjencia Kombëtare e Duhan Cigares (AKDC) me Autoritetin e Konkurrencës në rastet kur dyshon për një sjellje të mundshme antikonkurrese të ndërmarrjeve që operojnë në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit.

- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi institucioneve përkatëse dhe ndjekjen e zbatimit të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**

(\_\_\_\_\_)  
**Zv/Kryetar**

**Koço BROKA**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Eduard YPI**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R**